

STATUTI I SHOQERISE

"ON CONSTRUCTION" SHPK

Dt. 24.02.2021

Me cilesine e ortakeve themelues:

1.ENGJELLUSHE NALLBANI, e bija e Shyqyri, e dtl.02.01.1956 lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, shtetase Shqiptare, mbajtese e Leternjoftimit ID Nr.036834734 dhe Nr.Personal F65102054J, madhor me zotesi te plote per te vepruar

mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14/04/2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ne ligjin nr.9723 date 03/05/2007, " Per Qendren Kombetare te Bisnesit", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, Krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, " ON CONSTRUCTION " shpk.

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "ON CONSTRUCTION" shpk eshte person juridik I te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuara (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne daten kur kryhet regjistrimi I tyre ne QKB, pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Shoqeria "ON CONSTRUCTION" shpk eshte nje e tille, kapitali I se ciles ndahet ne kuota dhe qe themelohet ndermjet ortakeve qe perballojne humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne ambientet me adresen Rruga "Rauf Nallbani", pallati nr.2, hyrja nr1, ap.15, lagjia 15 Tetori, pallati ish Posta, Fier. Ajo mund te hape dege, filiale dhe agjensi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise sipas vendimit qe do te marre Asambleja e Ortakeve.

Engjellushaq Nallbani


Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Punime gjurmimi në tokë; Ndërtime civile dhe industriale; Rikonstrukcione dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash; Rrugë autostrada mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale; Punime nëntokësore, ura e vepra arti; Diga dhe tunele hidroteknike; Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje; Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë; Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime; Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike; Ndërtime për linjat/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë; Punime të inxhinierisë së mjedistit; Punime për prishjen e ndërtimeve; Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre; Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues); Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese; Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut; Sinjalistika rrugore jondriçuese; Barriera dhe mbrojtje rrugore; Ndërtime parafabrikat beton/arme, struktura metalike dhe drur; Punime strukturore speciale; Shtresa dhe mbistruktura speciale; Punime mbi shina dhe traversa; Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit; Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni; Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.; Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore; Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij; Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane; Punime topogjeodezike; Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë; Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime përujë. Mirëmbajtje objektësh. Studim-Projektim në: Plane kombëtare sektoriale; Plane të detajuar për zona të rëndësishme kombëtare; Plane sektoriale në nivel qarku; Plane sektoriale në nivel bashkie; Plane të detajuara vendore. Projektim arkitekturor. Projektim interiere; Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe. Objekte civile, industrial, turistike. Objekte me shkallë të lartë vështrësie; troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët. Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike. Objekte civile e turistike prej druri. Projektim të instalimeve hidrotermosaniare. Instalime termoteknike; kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme. Linjat e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. Sistemeve komplekse të telekomunikacionit. Sisteme të furnizimit me gaz. Sistemeve kundra zjarrit. Sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa. Impiante ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.). Ndriçimi rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimi të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj. Rrjete të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj. Diga. Furnizim me ujë, kolektorë shkarkimi. Ujësjellës-kanalizime urbane, rurale Vepra ujitje; kullimi; impiante vaditëse; diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha), damba, sifona, kaskada, kapërderdhës, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino. Vepra të trajtimit të ujit. Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi; shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse. Vepra naftësjellës; gazsjellës; vajsjellës etj. Vepra hidroteknike; kulla ekuilibri, porte; pontile. Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane

dytësore. Rrugë. Autostrada. Aeroporte; heliporte; hidroporte. Hekurudha; degëzime hekurudhore. Ura/viadukta, vepra arti dhe sisteme të tjera speciale. Tunele rrugore; hekurudhore. Rivlime inxhinierike. Rivlime inxhinierike kadastrale. Sisteme GIS. Bazamente gjeodezike. Fotogrametri dhe hartografi. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile; ekonomike. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët. Centrale hidraulike, termike. Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, ere etj. Nënstacione elektrike; linja të tensionit. Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës; Sinjalistikë jondrëqesë në rrugë, sheshe e parkime, autostrada, rrugë, hekurudha në degëzime, në aeroporte dhe heliporte. Sinjalistikë ndrëqesë në infrastrukturë. Studime të rrezikut sizmik në cdo nivel. Studime e projektme të ndërimit dhe mbylljes së venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta. Studime e projektme të ndërimit të impianteve të trajtimit të ujërave të zeza. -Shërbime Konsulente Teknike, Ligjore e Financiare. Të tjera si: Vlerësime: Mjedisore dhe Pasurive të paluajtshme; Restaurime në zbatim dhe projektim -Eksptizë teknike dhe teknologjike; Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. -Shit-blerje, import-eksportin e: Materiale ndërimit, Linjave makinerive dhe pajisjeve teknologjike bujqësore, blektorisë, agroperpunimit, asete fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, Sisteme frigoriferike, ventilimi etj dhe montim. -Auditime energjetike. Etj.

Neni 5

Kohezgjitja

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pa përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë dhe është në 1,00 kuota, vlera nominale e të cilave është 100,000 lekë.

Kapitali i mesipër do të ngurtesohet në bankë mbasi shoqëria të jetë regjistruar në QKB.

1. **ENGJELLUSHE NALLBANI**, kuota me vlerë të përgjithshme 100,000 lekë, që përbejnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.



Ortaket pergjigjen per humbjen e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit:

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe ne ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ortakët ne te njejtën masë ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne. Projekti I zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, ne rast se ka te tille, te pakten 45 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese te thirrur per te marre vendimin rreth ketij projekti.

Zvogelimi I kapitalit themeltar ne nje vlerë me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 5 te ketij statute, e bent e detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren minimale. Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne nje forme tjeter. Ne rast moszbatimi te kerkesave te ketij paragrafi, cdo person I interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqsore prishjen e shoqerise. Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimieshte bere ne ditën kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

Neni 8

Transferimi I kapitalit:

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejen pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjese te kapitalit themeltar. Projekti I transferimit I njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve. Ne rast se shoqeria nuk ka beret e ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperem, miratimi I transferimit konsiderohet I dhene.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTJESE

Neni 9



Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) Emerimin e shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) Percaktimin e shperblirneve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te ketij neni;

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi I vetem vendimmarres I shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratoret.

Vendimet merren pas konsultimit me shkrim te ortakeve, ne rast se ortaket miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit. Ortaket lajmerohen me leter rekomande te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ne kete leter njoftohet rendi I dites. Lajmerimi behet nga administrator ose, ne mungese te tij, nga eksperte kontabel I autorizuar, po qe se ka te tille. Secili ortak mund te kerkoje ligjerisht caktimin e nje mandatmbajtjesi te ngarkuar per thirrjen e asamblese dhe caktimin e rendit te dites.

Cdo mbledhje e asamblese e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anulohet.

Megjithate anulimi nuk ka vlere, ne rast se ortaket jane te pranishem ose te perfaqesuar.

Secili ortak k ate drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Secili ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter.

Ai mund te perfaqesohet edhe nga nje tjeter person.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaket qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Cdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Administrimi



Administratori i shoqerise eshte Znj. Engjellushe Nallbani, e bija e Shyqyri, e dtl.02.01.1956 lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, shtetase Shqiptare, mbajtese e Leternjoftimit ID Nr.036834734 dhe Nr.Personal F65102054J per nje afat 5 vjecar.

Ai emerohet dhe shkarkohet me vendim te asamblese se pergjithshme. Pervec kesaj administrator shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Neni 12

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoj shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullit te dokumenteve dhe librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatit dhe te nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise te veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ti paraqesi keto dokumente perpara asamblese te pergjithshme per miratim;

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve ai angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin esaj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injornin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statusit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statute qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.

Administratorit ose ortakeve qe nuk jane persona juridike nuk u lejohet te kontaktojne ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.



Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe I sjellin dem shoqerise, I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe I ngarkohen personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se badhku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder admionistratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim I asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimin e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Ortaku qe nuk eshte administrator, ka te drejte ne cdo kohe te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.

Neni 14

Viti Financiar

Viti Financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci I shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividenteve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar , sic edhe parashikohet nga ligji, ne raport me kuotat e zoteruara nga secili prej ortakeve.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel I autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.



Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaket, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

Neni 18

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te shoqerise.

Neni 19

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuara prishet:

- a) Kur mbaron kohe zgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te asamblese te pergjithshme;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet edhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me pikën e nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03/05/2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- e) Me vendim te gjyqates;

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja:

Shoqeria, me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.

Ortaket e shoqerise, qe bejne kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfitojne pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shocerite perfituese dhe sipas rastit nje kompesim me para, vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10 per qind te vleres.

Nominale te pjeseve te kapitalit themeltar te dhena.



Operacionet e permendura me lart mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likujdim te shoqerise qe zhduket, dhe kalimin e plote te trashegimise se saj te shoqerite perfituese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerive qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati I emerimit te likujdatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne QKB.

Neni 22

Likujdatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, di per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizik dhe juridik vendas apo te huaj.

Cdo mosmarreveshje apo konflikte qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne te kunderten ceshtja mund te behet object konflikti gjyqesor ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Fier.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specific ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statute, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te lindre midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 7 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare



"ON CONSTRUCTION" shpk, nenshikruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen tyre origjinale.

AKSIONER

ENGJELLUSHE NALLBANI

Engjellushe Nallbani
